



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I66-2

Prot.

Tiranë __3__/_11_/2025

Nr. Dok. 202503387/2

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë në Bulqizë

Drejtuar: Z. Drejtues i parë z. Artion DUKA
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

DIBËR

Kryekomisar z. Edvin PEÇI
Shef i Komisarimit të Policisë

BULQIZË

Për dijeni: Drejtues Madhor z. Ilir PRODA
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisaratin e Policisë Bulqizë nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Bulqizë, në datën 02.09.2025, sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin Z. Vullnet Topalli, z. Hazbi Selita, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të shoqëruarve, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 82/ 2024 "Për Policinë e Shtetit", si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, si dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme. Inspektimi ishte i paparalajmeruar.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me Shefin e Komisarariatit z. Edvin Peçi dhe Shefin e Sektorit të Krimeve të Rënda të Komisarariatit Policisë Bulqizë z. Arur Kurti, si dhe shefin e rendit z. Ardjan Balla, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, grupi i inspektimit u informua mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me trajtimin e të shoqëruarve dhe përmirësimin e kushteve në ambientin e shoqërimit të këtij komisaritati, sipas kritereve të përcaktuara në procedurat standarde.

Pasi mori informacionin e nevojshëm, grupi i monitorimit inspektoi ambientin e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, si dhe u njoh e administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar.

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambientit të shoqërimit nuk kishte ndryshime në krahasim me inspektimin e fundit, duke patur parasysh standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, brenda këtyre ambienteve, si dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit dërguar pas inspektimit të kryer në vitin 2024¹.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se²:

1. Ishte zbatuar rekomandimi, për të afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në ambientet e dhomave të shoqërimit në vende të aksesueshme me qëllim që ata të njihen me të drejtat e tyre ligjore.
2. Ishte zbatuar rekomandimi, për dhënien e kartës së të drejtave në momentin në të cilin palët hyjnë në komisarariat.

¹ Shkresë nr. K4/I58-2 prot., datë 25.10.2024 *“Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Bulqizë”*.

² Kthim përgjigje të shkresës tonë me nr. 9917/1 prot., datë 04.12.2024, nga Drejtoria Vendore e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Gjthashtu, u evidentua se nuk ishin zbatuar rekomandimet në lidhje me:

3. Ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Bulqizë, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të, ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, duke parashikuar përshtatjen e dhomave sipas kushteve për jetesë, dhe të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim ulur të personave të shoqëruar dhe të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur në konflikt me ligjin³.
4. Instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në të gjithë korridorin e institucionit, si dhe në ambientin e dhomës së shoqërimit në Komisaratin e Policisë Bulqizë.
5. Krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisaratis⁴.
6. Krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
7. Sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
8. Plotësimin me orëndi të nevojshme të dhomave të shoqërimit, me tavolina, si dhe pajisjen e tualeteve me lavamane dhe bolierë për ngrohjen e ujit, për të qenë sa më funksionale për personat e shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar në ambientet e Komisaratis të Policisë Bulqizë.
9. Trajnimin e punonjësve të policisë që janë përgjegjës për persona të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në konflikt me ligjin si dhe njohja me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, si dhe urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurave standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në Mjedise e Policisë”*.

Ndërkohë, në lidhje me rekomandimin për analizimin e moszbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në kompetencë të këtij institucioni, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive ndaj personave përgjegjës në DPPSH, pasi drejtuesit e institucionit të Komisaratis të

³ Kreu VI, pika 4, e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku parashikohet se: *“Dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për persona madhorë, mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20m², secila”*.

⁴ Kreu VI, pika 4/i1, e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”* miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Policisë Bulqizë por edhe Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër na informuan se **nuk** disponojnë fondet e nevojshme për realizimin e rekomandimeve të dhëna nga ana jonë për këtë institucion. Për këtë qëllim, Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, me anë të shkresës nr. 67/1 prot, datë 11.07.2025, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për mbështetje dhe shtim fondesh, duke planifikuar dhe punimet e nevojshme që duhet të kryehen në zbatim të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit. Për rrjedhojë, janë në pritje të çeljes së fondit dhe të kryerjes së investimeve të nevojshme për rikonstruksionin e plotë të Komisarariatit të Policisë Bulqizë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në përputhje me Procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022

Në përfundim të inspektimit, grupi inspektues vëren se megjithëse në Komisariatin e Policisë Bulqizë ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, nisur nga kushtet aktuale, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, **rezultoi se gjendja aktuale e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin e mëparshëm**, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, të ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës. Kjo ndërtesë ishte e vjetër dhe e amortizuar. Ambienti i shoqërimit përbëhej nga 3 (tre) dhoma shoqërimi të ndara më vete, përkatësisht 1 (një) dhomë shoqërimi për personat e rritur burra, 1 (një) dhomë shoqërimi për gra dhe 1 (një) dhomë shoqërimi për të mitur.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe të mjaftueshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, ku garantohet dhe siguria e tyre. Gjithashtu, dhoma e shoqërimit për të rritur ishte e pajisur me një stol për të mundësuar qëndrimin ulur të personave. Ndërsa në dhomën e shoqërimit për gra dhe të mitur në konflikt me ligjin, mungonin stolat dhe tavolina për të mundësuar qëndrimin ulur të personave të shoqëruar në këtë komisarariat. Përmasat e dhomës së shoqërimit për të rritur ishin 4X4m² për mbajtjen e 4 personave, ndërsa dhomat e shoqërimit për gra dhe për të mitur, ishin me përmasa më të vogla 3x3m² dhe kishin kapacitet për mbajtjen deri 3 persona për secilën dhomë.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin të siguruara me skarë hekuri në pjesën e jashtme, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise. Dritaret ishin me përmasa të tilla që lejonin mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Dhomat gjithashtu kishin edhe ndriçim artificial që sigurohej nga rrjeti elektrik. Dyert e dhomave ishin me profil druri, mbylleshin me çelës nga jashtë dhe kishin bravë të rregullt.

Mjediset e dhomave të shoqërimit ishin të mirëmbajtura, të lyera dhe të mbajtura pastër nga ana higjieno-sanitare. Ne vlerësojmë se kushtet higjieno-sanitare janë shumë të rëndësishme në ambientet e privimit të lirisë dhe gjendja e tyre varet nga organizimi i

punës dhe për këtë shkak Avokati i Popullit kërkon vëmendje maksimale nga drejtuesit e komisariatit dhe stafi përgjegjës. Pastërtia e ambienteve është thelbësore pasi tregon qartë kujdesin ndaj të shoqëruarve në këtë institucion.

Në të 3 dhomat e shoqërimit, ishin vendosur etiketimet sipas dhomave të shoqërimit për të rritur, gra dhe të mitur, siç parashikon procedura standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022.

Në fundin e korridorit të dhomave të shoqërimit ndodhen dhe funksionojnë tualetet, të ndara më vete për gratë dhe burrat, me sipërfaqe të mjaftueshme, por mungonin lavamane dhe bolierë për ngrohjen e ujit, të cilët janë të domosdoshëm për mbajtjen pastër të higjienës së personave të shoqëruar në këtë institucion. Ambientet e brendshme furnizohen me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje nga rrjeti i Ujësjellës Kanalizimeve Bulqizë.

Në Komisaratin e Policisë Bulqizë kishte gjenerator funksional për furnizimin me energji në rast defektesh. Ambientet e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje/ftohjeje.

Sipas strukturës, Komisarati i Policisë Bulqizë kishte në organikë 4 specialistë policie/OPGJ dhe 6 specialistë SPZ. Nga këqyrja e zyrave të specialistëve të policisë/OPGJ dhe ndihmës/specialistëve të policisë/SPZ, nuk u gjetën sende apo mjete, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje në zyrat e tyre.

Në Komisaratin e Policisë Bulqizë, nuk kishte dhomë të marrjes së provave materiale dhe sipas informacionit të drejtuesve të komisariatit provat materiale futen në një qese të etiketuar dhe më pas i dërgojnë në zyrat e provave materiale në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër.

Ndërkohë, mjediset e dhomave të shoqërimit, në ambientet e brendshme për të rritur si dhe ambientet e jashtme ishin të survejuara me kamera përgjatë 24 orëve. Ndërsa dhoma e shoqërimit për të mitur në konflikt me ligjin dhe dhoma e shoqërimit për gra, nuk ishin të survejuara me kamera. Mbikëqyrja me kamera në të gjithë mjedisin e komisarateve, përveç mjedisëve ku cenohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen si nga ana e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Së dyti, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisariatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, të ndaluarve apo të arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura. Vlen të theksohet se ai shërben për të garantuar besimin e qytetarëve te Policia e Shtetit.

Për sa më sipër, ky standard parashikohet edhe në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku përcaktohet se: *“Të gjitha ambientet e shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përjashto tualetin) si ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit, korridorit të tyre dhe pjesa e jashtme e dhomave të shoqërimit, të cilat lidhen dhe trasmentojnë pamje/imazhe në monitor të vendosur në ambientin e shoqërimit të sallës së komandimit/shërbimit të informacionit, DPV, komisariatet, stacionet e policisë”*.

Në Komisariatin e Policisë Bulqiz gjatë periudhës **01.01.2025** deri më **02.09.2025** ishin të shoqëruar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **76** persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 dhe 25/1 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, ku të gjithë të shoqëruarit ishin **76** shtetas madhorë burra, në konflikt me ligjin. Në momentin e inspektimit **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar në mjediset e komisarariatit, për rrjedhojë grupi i inspektimit nuk realizoi intervista lidhur me trajtimin që iu bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë nga momenti i shoqërimit, gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e shoqërimit, marrjes në pyetje apo intervistimit të tyre.

Gjithashtu, u informuam se karta e të drejtave të njeriut i jepet çdo personi të shoqëruar/ndaluar apo arrestuar, që në momentin e hyrjes në ambientet e komisarariatit duke garantuar njohjen e të drejtave që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Mekanizmi **Kombëtar sugjeron dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore** që në momentin e hyrjes në komisarariat⁵ dhe plotësimin e regjistrin në dinamikë dhe jo në momentin kur largohen nga ambientet e komisarariatit.

Gjatë inspektimit u evidentuan disa praktika, nga ku rezultoi se në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisariatin e Policisë Bulqizë, mbahej procesverbali përkatës dhe pasi firmosej, një kopje i jepej personit të shoqëruar dhe një kopje ruhej në arkivën e institucionit.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Bulqizë nuk kishte ambiente të sigurisë. Personat e arrestuar/ndaluar pasi evidentoheshin në regjistrin përkatës, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Dibër.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar, si dhe trajtimi i tyre

⁵ CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohej të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”⁶ dhe “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”⁷, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisaratin e Policisë Bulqizë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform parashikimeve ligjore të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde “*Rregullat Për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*” dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit.

Për rrjedhojë, u konstatua se ishte plotësuar standardi për pasqyrimin me saktësi dhe përgjigjësi të rubrikave të librit të shoqërimit nga punonjësit e policisë së zyrës të informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 5 orë në raste të veçanta, por mesatarisht ata mbaheshin për veprime rreth 4 orë. Rubrikat e regjistrat ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjigjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁸.

Në këtë komisarati kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Gjatë periudhës janar - shtator 2025 janë evidentuar 10 të arrestuar/ndaluar. Nga verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë, sipas shënimeve në regjistër.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarati kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, por gjatë vitit 2025 nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë nga ana e këtyre personave.

Nga inspektimi u konstatua se Komisarati i Policisë Bulqizë ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2025 nuk kishte pasur veprime për të miturit në konflikt me ligjin⁹.

⁶ Kreu VII, pika 5 e procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

⁷ Kreu XI, pika 1 e 3 e procedurave standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.

⁸ Kreu VIII “Procedura të Dokumentimit të Veprimit të Shoqërimit” parashikuar me Urdhrin Nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

⁹ Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Avokati popullit thekson se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standart thelbësor me funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Ambientet e intervistimit

Në Komisaratin e Policisë e Policisë Bulqizë, oficerët e Policisë Gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente, përsa kohë shërbejnë edhe si zyra intervistimi apo për marrjen në pyetje të të shoqëruarve në konflikt me ligjin, **nuk** ishin të monitoruara me kamera, për mbajtjen në vëzhgim të sjelljes dhe veprimeve procedurale që kryejnë oficerët e Policisë Gjyqësore me këta shtetas.

Krijimi i zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe instalimi i sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, është rekomandim i përsëritur në vite nga Avokati i Popullit referuar standardeve ndërkombëtare¹⁰, të cilat e konsiderojnë procesin e monitorimit filmik si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e Policisë së Shtetit, ashtu dhe nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve.

Ky standard ka gjetur rregullim tashmë edhe në procedurat standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit. Në këtë dokument shprehet qartë se, në mjedisin ku ndodhen dhomat e shoqërimit, duhet të krijohet dhe një dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen). Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë dhe kushtet për: “*Instalimin e sistemeve dhe pajisjeve për regjistrimin elektronik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e Policisë Gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar*”¹¹. Dokumentimi elektronik i intervistimit të personave të shoqëruar është një masë tepër efikase për parandalimin e dhunës psikologjike.

Në raportin drejtuar qeverisë shqiptare mbi vizitën e Komitetit për Parandalimin e Torturës KPT-së në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit: “*Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave*

¹⁰ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”. Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2018) 31 [par.20]. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>.

¹¹ Kreu VI, pika 4/i.1.1 të procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtme fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare”.

KPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të shoqëruar”¹².

Komisariati i Policisë Bulqizë në kushtet aktuale nuk posedon hapësirë të posaçme për komunikimin apo intervistimin me persona të mitur, ndaj MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët dhe pyetja e tyre duhet të realizohen në një ambient që duhet të jetë i përshtatur në mënyrë të posaçme për zhvillimin e intervistimeve me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohen pasoja të rënda deri në trauma tek të miturit që janë në konflikt me ligjin.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Në këtë komisarikat, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi rezultoi, se për personat e shoqëruar mbahej procesverbali tip “Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”. Njëkohësisht, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet një kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Në dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale në nenet 34/a, gërma “c” dhe 34/b gërma “a”, si dhe në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, në pikën 4 të nenit 19, përcaktohet se: “*Çdo shtetas në momentin e privimit të lirisë në mjediset e Policisë së Shtetit, ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin mbrojtës*”.

Në ambientet e Komisarariatit të Policisë Bulqizë ishte afishuar lista e avokatëve kryesisht të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe e përditësuar për vitin 2025. Sipas informacionit të drejtuesve të policisë, personave të arrestuar/ndaluar iu respektohej e drejta për avokat mbrojtës kryesisht, në rastin kur të shoqëruarit nuk kanë mundësi

¹² Electronic recording of police intervistës (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

financiare, nga lista e avokatëve të miratuar nga organi i prokurorisë sikurse parashikohet në Kodin e Procedurës Penale.

Sipas informacionit të stafit, përgjithësisht avokati paraqitet në mjediset e policisë jo më vonë se 1 orë nga momenti i njoftimit nga personeli i shërbimit ose nga specialistët e policisë të ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale me të shoqëruarin apo të arrestuarin e dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në regjistrin ku evidentohen takimet e të arrestuarit me avokatin mbrojtës, shënohej emri dhe mbiemri i avokatit, si dhe ora e takimit, por jo ora e njoftimit.

KPT gjatë vizitës inspektuese në Shqipëri të zhvilluar në maj 2023 në institucionet policore, në raportin dërguar autoriteteve të qeverisë së Shqipërisë, përta i përket masave mbrojtëse themelore kundër keqtrajtimit të personit (përkatësisht, e drejta e njoftimit për ndalimin dhe e drejta për avokat dhe mjek), ka konstatuar se: *“Delegacioni dëgjoi disa pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e tyre për avokat kryesisht vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati. Gjithashtu janë marrë ankesa se avokatët kryesisht nuk kanë ofruar ndonjë ndihmë kuptimplotë. Për më shumë, informacioni i mbledhur gjatë vizitës sugjeronte se ekzaminimi fillestar mjekësor i personave të ndaluar në përgjithësi ishte ende i kufizuar tek pyetjet për gjendjen e tyre shëndetësore, pa kryer një ekzaminim fizik”*.

Përta më sipër, KPT ka rekomanduar që: *“Autoritetet shqiptare duhet t’u kujtojnë të gjithë oficerëve të policisë detyrimin ligjor për t’i dhënë akses ndaj një avokati që nga fillimi i heqjes së lirisë së një personi. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa në konsultim me Dhomën e Avokatëve për t’u siguruar që avokatëve kryesisht t’u kujtohet roli i tyre kyç në parandalimin e keqtrajtimit duke qenë të pranishëm në komisariatet e policisë dhe duke ndërhyrë që në fillim të privimit të lirisë, duke përfaqësuar sa më mirë të munden interesat e personave që janë të mandatuar të ndihmojnë dhe, më konkretisht, duke ndërmarrë veprimet e duhura sa herë që ka tregues se persona të tillë janë keqtrajtuar (ose mund të jenë) keqtrajtuar nga policia. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa për të promovuar, në kuadrin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të avokatëve, një kulturë ku mosndjekja e akuzave për keqtrajtim policor të konsiderohet si joetike dhe joprofesionale”¹³*.

Ndërkohë nga inspektimi, u evidentua gjithashtu një praktikë e mirë në Komisaratin e Policisë Bulqizë, ku në rastet e shoqërimit apo arrestimit të personit të mitur në konflikt me ligjin, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Psikologu sigurohej menjëherë nga Bashkia Bulqizë por edhe nga Shkolla e Mesme e qytetit, dhe sipas rastit vonesa në këto raste ishte gjysmë ore. **Mekanizmi Kombëtar kërkon që avokati dhe psikologu të jenë të pranishëm, që në** në momentin e hyrjes të të shoqëruarve në komisarariat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre dhe mbështetje psikologjike në rrethanat në të cilat këta shtetas ndodhen në institucion.

Ndërsa në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë për të marrë ndihmën mjekësore në Spitalin e Bulqizës.

¹³ efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://rm.coe.int/1680ae233b

Nga inspektimi në ambientin e shoqërimit në Komisaratin e Policisë Bulqizë, grupi i inspektimit konstatoi se në dhomat e shoqërimit dhe në korridore ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të shoqëruar, por ato kishin nevojë të rifreskohen me të reja dhe në gjuhë shqip dhe disa gjuhë të huaja. Gjithashtu, afishimi i të drejtave duhet të bëhet dhe në vende të tjera të aksesueshme nga personat që ndodhen në mjediset e policisë, me qëllim për të dhënë mundësinë e leximit dhe kuptimit të këtyre të drejtave nga ana e tyre.

Përsa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Bulqizë, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VI, pika 4 të procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të, ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, duke parashikuar përshtatjen e dhomave sipas kushteve për jetesë, dhe të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrim ulur të personave të shoqëruar dhe të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur në konflikt me ligjin¹⁴.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në të gjithë korridorin e institucionit, si dhe në ambientin e dhomës së shoqërimit në Komisaratin e Policisë Bulqizë.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, si dhe të ndërpritet praktika e marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisarariatit¹⁵.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

¹⁴ Kreu VI, pika 4, e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, ku parashikohet se: “Dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për persona madhorë, mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20m², secila”.

¹⁵ Kreu VI, pika 4/i1, e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

5. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
6. Marrjen e masave, për krijimin më vete të dhomës për mbajtjen e provave materiale dhe largimin nga zyrat e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore të sendeve të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.
7. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin me orendi të nevojshme të dhomave të shoqërimit, me tavolina, si dhe pajisjen e tualeteve me lavamane dhe bolierë për ngrohjen e ujit, për të qenë sa më funksionale për personat e shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Bulqizë.
8. Marrjen e masave për trajnimin e punonjësve të policisë që janë përgjegjës për persona të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në konflikt me ligjin si dhe njohja me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurave standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, si dhe urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurave standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në Mjedise e Policisë”*.
9. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit, për analizimin e mos zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në kompetencë të këtij institucioni, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive për dhënien e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI
dv**